



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “NIKA Pro-ing shpk” të datës 20.10.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i tribunës lindore te stadiumi 2 Korriku – faza e III-të” me nr. të prokurimit 616-25-7285-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHE**t kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “NIKA Pro-ing shpk” të datës 20.10.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i tribunës lindore te stadiumi 2 Korriku – faza e III-të” me nr. të prokurimit 616-25-7285-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHE**t autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHE**n palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “NIKA Pro-ing shpk” (tutje “parashtruesi”) me datë 20.10.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i tribunës lindore te stadiumi 2 Korriku – faza e III-të” me nr. të prokurimit 616-25-7285-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

DEKLARATA PER THEMELIMIN E GRUPIT nga GOE i rekomanduar nuk është sipas formularit standard te miratuar nga KRPP me datë 11.11.2024.

Marrëveshja e themelimit te grupit te operatoreve ekonomik nuk është konform formularit standart te miratuar nga KRPP ku duhet të ndahet përqindja , përgjegjësit etj.

GOE i rekomanduar ka ofruar autorizime ku nuk ceket as titulli i aktivitetit as numri i prokurimit por mbi te gjitha nuk ceket se per cilat artikuj janë ato autorizime.

Eshte ne kundërshtim me kriteret e përcaktuara ne Njoftimi per Kontrate dhe Dose Tenderit.

Këto autorizime janë fiktive dhe jo legjitime.

8- Operatori ekonomik duhet te ofroje certifikata CE dhe ENEC per trupa ndriqes

Argumenti ynë:

GOE i rekomanduar ka ofruar certifikata te nxjerrura nga google dhe jo sipas kërkes se AK.

Kjo kërkesë nuk është përmbushur konform kriterëve të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe DT pasi kanë ofruar vetëm certifikata te nxjerrura nga google

Parashtruesi po ashtu ka parashtruar pretendime ankimore sipas të cilave oferta e tenderuesit te rekomanduar për kontratë është e papërgjegjshme për arsyet e prezantuara në kërkesën për rishqyrtim.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit është gjetur se tenderuesi i rekomanduar mbi bazën e vlerësimit dhe të gjeturave të komisionit vlerësues është konstatuar marrëveshja për themelimin e GOE është hartuar në mënyrë të rregullt. Po ashtu tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar me rregull sipas DT po ashtu edhe licensat dhe certifikatat për të cilat bëhet fjalë në pretendimet ankimore.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 21.10.2025



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.